

## Përmbajtja e plehut të lopëve / Kg/T

Përmbajtja e plehut organik	Plehu organik i ngurtë	Plehu i lëngët
Lënda e Thatë, %	25	10
Materie organike, %	17.5	5
Azot (N), kg	5,5	1
Fosfor (P <sub>2</sub> O <sub>5</sub> ), kg	2,6	0,2
Kalium (K <sub>2</sub> O), kg	7,2	3

## KOHA E SHPËRNDARJES SË PLEHUT TË STALLËS

- Në baze të rregullave të EU plehu i stallës nuk lejohet të shpërndahet prej muajit Nëntor deri në muajin Mars.
  - Arsyeja pse nuk lejohet të shpërndahet plehu i stallës në këtë periudhë është sepse bimët në këtë kohë nuk e shfrytëzojnë plehun dhe ekziston rreziku i ndotjes së ujerave.
  - Po ashtu nuk lejohet shpërndarja e plehu të stallës në tokat me ngrica dhe në tokat të cilat kanë ujera sipërfaqësor dhe në të cilat rrjedhin ujërat.
  - Koha me e përshtatshme për shpërndarjen e plehut është në fillim të pranverës.
  - Rekomandohet që pas shpërndarjes të bëhet mbulimi i plehut me anë të lëvrimit apo nëse ka mundësi të behet spërkatja me ujë.
- Mbulimi duhet të kryhet brenda 4 orëve pas shpërndarjes së plehut.

## Respektimi i distancës në ndërtimin e fermës së lopëve larg vendbanimeve

- Secili vend i Bashkimit Evropian ka rregulloret e brendshme lidhur me lokacionin e ndërtimit të fermave.
- Në baze të standardeve të Francës kur bëhet ndërtimi i fermës për lopë duhet të respektohen këto standarde:
- duhet të përdoren brusha speciale. Po ashtu edhe pjesët e gomave thithëse duhet të pastrohen në mënyrë të njëjtë.

- >> 100 m larg vendbanimit
- >> 100 m larg fushave të sportit
- >> 100 m larg kampeve për piknik
- >> 35 m larg lumenjve apo burimeve të ujit
- >> 200 m larg plazheve
- >> 500 m larg bazeneve të peshqve



# MENAXHIMI I PLEHUT TË STALLËS



## PLEHU I STALLËS

- Plehu i stallës është një produkt sekondar i pa evitueshëm nga fermat e kafshëve dhe të gjithë fermerët që merren me mbarësimin e kafshëve duhet të kenë kujdes në menaxhimin dhe ruajtjen e plehut.
- Nëse plehu i stallës menaxhohet dhe ruhet ashtu siç kërkohet, mund të jetë një burim i vlefshëm ushqyes për kulturat bujqësore.
- Plehu i stallës përmirëson strukturën e tokës e cila është shtrat i bimës. Toka me pleh të stallës është më e pasur me mikroorganizma, mbanë me shume lagështinë, ngrohet me shpejtë dhe ka një strukturë të shkrifet në të cilën rrënjët e bimëve depërtojnë me lehtë në tokë.
- Menaxhimi joadekuat i plehrave mund të rezultojë në degradim të mjedisit, dëmtim të lashtave, dhe konfliktet me fqinjët dhe publikun për shkak të kundërmimit, dëmtueseve, apo të vetive tjera negative.
- Menaxhimi i duhur i plehrave duhet të ketë parasysh të gjithë aspektet e operacionale:

- > Si dhe ku është prodhuar plehu.
- > Si është depozituara plehu i stallës.
- > Si është përdorur apo do të përdoret në fund



## Renditja e lopëve për mjelje

- Kafshët janë relativisht joefikase në shfrytëzimin e N, P dhe K nga ushqimet e tyre, rreth 50% e këtyre elementëve kalojnë nëpërmjet fecesit. Këto materiale ushqyese mund të përfundojnë në pleh organik apo, në rastin e N, të humbin fare në atmosferë.
- Sasia dhe lloji i shtrojës (nëse ka) po ashtu do të ndikojnë në përmbajtjen e plehut të stallës.
- Cilësia e plehut të stallës ndryshon në vartësi nga lloji i kafshës.

### PËRDORIMI I PLEHUT TË STALLËS

- Në baze të rregullave të Bashkimit Evropian në një hektar tok duhet të shpërndahen vetëm 170 kg Azot.
- Kjo nënkupton sasinë e përgjithshme të Azotit nga plehu i stallës dhe plehu artificial.

### KAPACITETI I DEPOS SE PLEHUT

- Në baze të rregullave të Bashkimit Evropian depoja e plehut duhet të ketë kapacitet për ruajtje për 12 muaj.
- Kapaciteti i depos se plehut për një lopë duhet të jetë 0.9 m<sup>3</sup> në muaj apo në vit 10 m<sup>3</sup> për një lopë.
- Secili vend ka rregulloret e brendshme lidhur me kapacitetin e depos së plehut.
- Depoja e plehut duhet të jetë e mbuluar me materiale që pengojnë depërtimin e të reshurave të shiut.
- Plehu i lëngët duhet të mbliidhet në depo të veçante dhe mos të ketë kontakt me ujërat nëntokësor dhe ujërat e shiut.
- Qëllimi kryesor është që të pengohet ndotja e tokës dhe ujerave të pijes.

- Në baze të kushteve tona në Kosovë, rekomandohet që depoja e plehut të ketë kapacitet për së paku 6 muaj të deponimit të plehut.
- Rekomandohet që plehu i lëngët të ruhet ndaras dhe mos të depërtojë ujërat e shiut.
- Depoja e plehut paraqet kërcenim për cilësinë e ujit nga nitratet dhe patogjenët e ndryshëm nëse nuk është e ndërtuar mirë.

## SHPËRNDARJA E PLEHUT TË KAFSHËVE

- Për të shpërndarë me lehtë plehun e stallës i cili ka kashtë, duhet të lihet se paku një vit dhe duhet të mbulohet në mënyrë që të behet kompostimi i plehut.
- Plehu i cili ka kashtë dhe është i freskët bimët nuk mundin ta shfrytëzojnë, këtij plehu i duhen se paku dy muaj për të qenë i shfrytëzueshëm nga bimët.
- Me qëllim të përgatitjes sa me të mirë të kompostimit të plehut të stallës, duhet së paku një her brenda vitit të rrotullohet plehu në mënyrë që të behet kompostimi më mirë.